



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 28.07.2015 ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Jelena Bontic dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: MAP, OSBE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina, Mirjeta Heta dhe Flaka Zairi, praktikante në Komision, nga UNDP-ja.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 15.07.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e përgjithshme administrative;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 15.07.2015;

Procesverbali i dt. 15 korrik 2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e përgjithshme administrative;

Zenun Pajaziti – i njoftoi anëtarët e komisionit, që është shtyrë dëgjimi publik i cili ishte paraparë të mbahet me datën 22.07.2015 për Projektligjin për Procedurën e përgjithshme administrative dhe të formohet një grup punues për hartimin e këtij ligji, në këtë grup punues kanë shprehur interesimin që të jenë pjesëmarrës përfaqësuesit e Komisionit Evropian, UNDP, OSCE dhe komentet e tyre për ligjin.

Ai pastaj hapi debat,

Sadri Ferati – propozoi që të caktohet grupi punues dhe të bëhet përzgjedhja e ekspertit juridik rreth gjuhës së përdorur për ligj, që para fillimit të sesionit vjeshtor të mbledhet komisioni për të rishikuar edhe njëherë propozimet lidhur me projektligjin dhe rekomandoi që ekspertët të

përmirësojnë tekstin për projektligjin dhe gjuha juridike të jetë më e qartë, që teksti të plotësohet me afatet më të shkurtra për procedurën administrative.

Alma Lama – meqë për arsye objektive ka munguar në mbledhjet e kaluara, kur komisioni ka miratuar në parim projektligjin, ajo propozoi që projektligji të kthehet për shkak që teksti i projektligjit është i pakuptueshëm dhe si model të merret Ligji për Procedurën e përgjithshme administrative të Shqipërisë, për më tepër më befason fakti meqë SIGMA ka qenë gjithashtu hartuese e tekstit të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative të Shqipërisë, ashtu siç është hartuese e tekstit të projektligjit në fjalë dhe këto dy tekste të hartuara janë krejtësisht të ndryshme dhe kontraverse dhe meqë për projektligjin duhet të hartohet një numër i madh i amendamenteve që do të konsiderohet sikur një projektligj i ri, atëherë projektligji do të konsiderohet si projektligj i Kuvendit.

Xhevahire Izmaku – propozoi që të dëgjohen edhe njëherë përfaqësuesit e Qeverisë.

Shqipe Pantina – vërejtjet e saja i ka dhënë në procedurën para miratimit në parim të projektligjit dhe dy vërejtjet e saj janë: gjuha joadekuate e tekstit dhe termi i instituteve të reja, ajo propozoi që të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit për shqyrtimin e projektligjit kohë shtesë.

Pal Lekaj – si grup parlamentar i kemi dhënë sugjerimet tona për projektligjin të cilat tani do t'i dorëzojmë në formë të amendamenteve në grupin punues.

Zafir Berisha – ai propozojë formimin e grupit punues duke i propozuar për anëtarë Sadri Feratin dhe Pal Lekaj.

Alma Lama – duke replikuar diskutimet e parafolësve lidhur me projektligjin, ajo tha se ligji duhet të jetë i shkurtër, i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë.

Xhevahire Izmaku – u pajtua me propozimet e deputetit Zafir Berisha për anëtarë të grupit punues që ta udhëheqin grupin punues z.Ferati dhe z. Lekaj.

Zenun Pajaziti – propozoi për ekspert për grupin punues Prof. Dr. Flamur Hysenin.

Shqipe Pantina – ajo tha se jo çdo juristë e njeh ligjin për procedurën administrative dhe propozoi për ekspert për grup punues akademik Esat Stavileci.

Konstatim- Komisioni vendosi që grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e ligjit për procedurën administrative të përbëhet nga Sadri Ferati, Pal Lekaj dhe Jelena Bontic. Komisioni gjithashtu vendosi me shumicë votash “për” dhe një votë “kundër” nga znj. Shqipe Pantina që Prof. Dr. Flamur Hyseni të caktohet ekspert për amendamentimin e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

4. Të ndryshme.

Xhevahire Izmaku – propozoi që të bëhet një riplanifikim i punës së komisionit gjatë sesionit vjeshtor, në mënyrë që komisioni të jetë më efektiv për arsye se ajo konsideron se për arsye të angazhimeve të tjera që anëtarët e komisionit i kanë pasur në cilësinë e deputetëve dhe duhet të bëhet një riplanifikim i planit të punës, duke e përmendur që me procedurën për plotësim ndryshimin e ligjit për RTK-në, komisioni është vonuar.

Mbledhja përfundoi në ora:14:05

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
